

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6259  
E martë, 9 mars 2021  
çmimi 0.40 €

## Mbahet konferenca "Roli i gruas në institucionet e sigurisë"

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

DHJETË VJET QË NGA FILLIMI I DIALOGUT KOSOVË - SERBI | FAQE 4-5

# DIALOGU KOSOVË - SERBI NUK SOLLI REZULTATET E PRITURA

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë vlerësuar se ky proces nuk ka sjellë rezultatet e pritura. Në dhjetëvjetorin e fillimit të këtij procesi hulumtuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se dialogu i Brukselit ka sjellë disa përfitime për Kosovën. Por, sipas tyre, për këto përfitime Kosova ka bërë edhe shumë kompromise. Ndërsa ish-ministrja për dialog, Edita Tahiri, ka thënë se ky proces ka qenë rruga më e drejtë e cila ka sjellë rezultate për Kosovën, sidomos për integrimin e pjesës veriore në sistemin shtetëror të Kosovës



## PZAP-i ANULON VOTAT E PARTIVE BOSHNJAKE DHE ROME NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE

FAQE 3



SHUMICA E ZYRTARËVE  
POLITIKË NUK I NDAJNË  
TË HYRAT ME  
BASHKËSHORTET E TYRE

FAQE 7

## OPINION

### A ISHTE FITORJA NË ZGJEDHJE REVOLUCION ELEKTORAL APO TRUK KIBERNETIK E DIPLOMATIK?

F. 6

Milazim  
KRASNIQI



## TRIADA E KOSOVËS

Shkruan:  
Bedri ISLAMI



## AKTUALE



212 TË SHËRUAR DHE  
587 RASTE TË REJA ME COVID  
NË KOSOVË F. 3

## EKONOMI



GRATË QË UDHËHEQIN BIZNESE  
TË VOGLA PËRFITOJNË NGA  
PROGRAMI I RIMËKËMBJES F. 9

GASTRONOMËT  
PARALAJMËROJNË PROTESTA F. 9

## SPORT

SHABANI ME PLOT MUNGESA  
PUBLIKON LISTËN KUNDËR  
AUSTRISE F. 14

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Papa Françesku përfundon vizitën historike në Irak

BAGDAD, 8 MARS - Papa Françesku ka përfunduar më 8 mars vizitën e tij historike në Irak. Presidenti irakian Barham Salih e ka shoqëruar 84-vjeçarën me tepih të kuq në aeroportin e Bagdadit. Përgjatë vizitës, të parën ndonjëherë të Papës në Irak, ai ka qenë në katër qytete irakiane, duke përfshirë Mosulin, ish-qendrën e grupit ekstremist Shteti Islamik (IS). Ai u ka thënë irakianëve se "paqja është më e fuqishme sesa lufta",

dhe se Iraku do të mbetet gjithmonë në zemrën e tij. Lideri i botës së krishterë ka realizuar një bisedë edhe me klerikun mysliman shiit, Ayatollah Ali al-Sistani. Ekspertët e shëndetit publik kanë thënë para vizitës se shqetësohen që turmat e mëdha të njerëzve mund të ndikojnë në përhapje të Covid-19 në shtetin që po përballet rëndë me pandeminë. Papa dhe pjesëtarët e

delegacionit të tij janë vaksinuar kundër Covidit, por jo edhe shumica e irakianëve. Iraku po përballet me një tjetër valë të Covidit, të nxitur nga varianti i ri i virusit që është raportuar fillimisht në Britani. Në total 13 500 persona kanë vdekur me Covid në Irak, derisa numri i të infektuarve arrin në 720 000. Iraku konsiderohet shtet që përballet me menaxhim të dobët dhe korrupsion kronik.



## Zvicra voton për ndalim të mbulesës së plotë të fytyrës në publik

BERN, 8 MARS - Votuesit në Zvicër kanë mbështetur ndalesën për mbulim të plotë të fytyrës në vendet publike, në atë që është konsideruar si referendum "kundër burkas", ndonjëse mbulesat islame nuk janë përmendur në veçanti në propozim. Rezultatet zyrtare të 7 marsit kanë treguar se 51.2 për qind e votuesve kanë mbështetur ndalesën, kurse pjesëmarrja në votime ka qenë 50.8 për qind. Gati 1 427 000 votues kanë qenë në të mirë të ndalesës, ndërsa 1 360 000 kanë qenë kundër. Edhe sondazhet kanë parashikuar se rezultati do të jetë i afërt. Referendumi, i shtyrë përpara

nga grupet e ekstremit të djathtë, ka bërë thirrje që edhe më pak gra të vendosin mbulesat e tyre të plota islamike. Propozimi "Po kundër ndalesës për mbulesë të plotë", nuk ka përmendur saktësisht burkan apo nikabin. Megjithatë, në posterët e fushatave janë parë mbishkrimet "Ndalni islamit radikal" dhe "Ndalni ekstremizmin!", duke shfaqur gratë me nikab të zi. Burka është veshje që mbulon gjithë fytyrën dhe trupin e grave konservatore myslimane, derisa nikabi ua mbulon gjithë trupin, përveç syve. Rezultati zgjedhor nënkupton që askush nuk



mund ta mbulojë plotësisht fytyrën në publik. Përjashtime do të bëhen nëpër vende të lutjes, në disa

organizime kulturore si dhe për arsye shëndetësore. Autoritetet do të kenë kohë dy vjet për të hartuar në detaje

legjislacionin.

Qeveria zvicerane dhe parlamenti kanë kundërshtuar ndalesën e tillë në nivel kombëtar. Këshilli Islamik në Zvicër e ka konsideruar ndalesën "një zhgënjim të madh për myslimanët". Sipas të dhënave qeveritare, rreth 5.5 për qind e popullsisë zvicerane përbëhet nga myslimanët. Referendumi ka ardhur në kohën kur maskat në fytyrë janë të detyrueshme në dyqane dhe transport publik për shkak të pandemisë së Covid-19. Në Evropë, fqinjët e Zvicrës, Franca dhe Austria, kanë ndaluar mbulesën e plotë të fytyrës, ashtu sikurse Belgjika, Bullgaria dhe Danimarka.

## Presidenti sirian dhe gruaja e tij infektohen me Covid



DAMASK, 8 MARS - Presidenti sirian Bashar al-Assad dhe gruaja e tij kanë rezultuar pozitivë në testet për Covid. Në një deklaratë nga zyra e Assadit më 8 mars, është thënë se të dy janë testuar pasi kanë pasur simptoma të lehta të Covidit. Assad, 55-vjeçar dhe gruaja e tij Asma, 45-vjeçare, do të kthehen në punë pasi të kalojnë dy apo tre javë të izolimit në shtëpinë e tyre, është thënë në deklaratë, duke shtuar që të dy janë mirë me shëndet dhe në gjendje

stabile. Siria është përfshirë në luftë civile që ka nisur fillimisht si protestë paqësore kundër regjimit, në mars të viti 2011. Zyrtarisht deri më tani janë regjistruar 16 000 persona të infektuar me koronavirus, në zonat që kontrollojnë qeveria, si dhe 1 063 viktima, mirëpo numrat besohet se janë shumë më të lartë. Siria ka njoftuar javën e kaluar se do ta nisë fushatën e vaksinimit pa dhënë shumë hollësi. Qeveria ka thënë se ka siguruar vaksinat nga një shtet mik, por ka dhënë emër. Ky

njoftim ka ardhur teksa kanë qarkulluar raportime në mediat ndërkombëtare dhe ato izraelite se Izraeli ka paguar Rusinë 1.2 milion dollarë për t'i ofruar qeverisë siriane vaksinat kundër koronavirusit në kuadër të marrëveshjes që ka garantuar lirim të mbajtur në Damask. Detajet vazhdojnë të jenë të paqarta, pasi Siria mohon këto pretendime dhe Moska nuk përgjigjet në këtë çështje.

## Në Danimarkë zbulohen 31 lloje të ndryshme të Covidit

Kopenhagë, 8 mars - Ministri i Shëndetësisë i Danimarkës, Magnus Heunicke, ka njoftuar se në

vend janë zbuluar 31 lloje të ndryshme të Covid-19. Duke bërë një deklaratë në llogarinë e tij në media

sociale, Heunicke ka pohuar se kohën e fundit janë zbuluar 15 lloje të reja të Covid-19 në Danimarkë,

duke njoftuar se në këtë shtet deri më tani janë hasur 31 lloje të ndryshme të Covidit.



# PZAP-i anulon votat e partive boshnjake dhe rome në komunat me shumicë serbe



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 8 MARS** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka anuluar në tërësi votat në zgjedhjet e 14 shkurtit për subjektet politike boshnjake në komunat e banuara me shumicë serbe, siç janë Zubin Potoku, Shtërpca, Ranillugu, Graçanica, Parteshi, Klokoti, Novobërda, Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Leposaviqi. PZAP-i ka miratuar pjesërisht apelet nga subjektet politike boshnjake Iniciativa Jonë (Nasha Iniciativa), Unioni Socialdemokrat (SDU) dhe Partia e Re Demokratike (NDS), të cilat kërkuar që të anulohen votat e ardhura nga komuniteti serb për partinë "Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq". Me këtë vendim, PZAP-i ka anuluar 4 205 vota të cilat i kishte siguruar subjekti politik boshnjak, i udhëhequr nga Adrijana Hoxhiq në komunat e banuara me shumicë serbe. Hoxhiqi, sipas rezultetit përfundimtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kishte fituar 6 422 vota apo një ulëse në Kuvendin e Kosovës. Ndërkaq koalicionit Vakati janë anuluar 583 vota të cilat i ka fituar në këto komuna. Unioni Socialdemokrat i Duda Bales me këtë vendim të PZAP-it ka mbetur pa 165 vota si dhe Iniciativa Jonë ka humbur 9

vota, kurse Partia e Re Demokratike 14 vota. "Urdhërohet KQZ-ja që votat e përfshira në fletëvotimet e anuluar t'i heqë nga rezultati përfundimtar", thuhet në vendim. Përfaqësuesit politikë të komunitetit boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptas pretendojnë se partia boshnjake "Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq" dhe "Iniciativa Rome" kanë siguruar vota në zgjedhjet e 14 shkurtit me ndihmën e Listës Serbe. Komunitetet joserbe thonë se këto dy parti në zgjedhjet e 14 shkurtit kanë marrë vota në vendbanime ku nuk jetojnë këto komunitete. Në arsyetimin e vendimit, PZAP-i thotë se votat e përgjithshme të partive boshnjake u rritën për 49 për qind, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2019 dhe, sipas këtij paneli, kjo rritje erdhi për "një arsye të vetme ku, si asnjëherë më parë, mijëra votues të komunitetit serb në Kosovë votuan për përfaqësuesit boshnjakë". "Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës, subjekte të caktuara, si në këtë rast 'Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq' dhe koalicioni 'Vakati', kanë marrë shumicën e votave nga komuniteti serb, që në këtë rast paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit boshnjak, krejt kjo

në thelb paraqet minim të procesit zgjedhor, por edhe të integritetit të këtij procesi", ka njoftuar PZAP-i. PZAP-i ka vendosur të anulojë edhe mbi 800 vota për Iniciativën Rome, të cilat i kishte siguruar në komunat me shumicë serbe. Iniciativa Rome ka siguruar 4 049 vota. "Votat e marra në vendvotimet nga Iniciativa Rome janë në disproporcion me numrin e banorëve të komunitetit rom, e të cilat paraqesin vota të pavlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komuniteti tjetër të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komuniteti tjetër dhe, si të tilla, nuk paraqesin lidhje objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar", thuhet në vendimin e PZAP-it. "Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese të cilat Republika e Kosovës i ka marrë, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore", ka shtuar PZAP. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankesë brenda 24 orëve në Gjykatën Supreme.

**PZAP-i merr vendim edhe për rinumërim të votave të AAK-së**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe

Parashtrësia (PZAP) ka pranuar ankesën e kandidatës për deputete nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Florentina Gjergjaj, e cila ka kërkuar rinumërim të votave me kusht dhe atyre nga diaspora të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Në vendimin e së hënës, PZAP-i ka thënë se votat do të rinumërohen vetëm për kandidatët e AAK-së. Në ankesën e saj, Gjergjaj ka pretenduar se ka fituar 3 855 vota, derisa kandidatja tjetër, Meliza Haradinaj-Stublla, ka ftuar 3 715 vota. "Si dëshmi për pretendimet e saj, ka bashkëngjitur në apel rezultatet e Qendrës dhe Numërimit të Rezultateve të datës 26.02.2021", është thënë në vendimin e PZAP-it. Lidhur me këtë vendim ka reaguar edhe vetë Haradinaj-Stublla, e cila aktualisht është ministre në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Në një postim në rrjetin social "Facebook", ajo ka thënë se mirëpret këtë numërim të votave. "Ky rinumërim është një hap përpara zbardhjes së incizimit të inskenuar që pretendon përfshirjen e bashkëshortit tim në vjedhjen e votave! Përsëris, me bindje të plotë që as unë, as bashkëshorti e asnjë familjar e bashkëpunëtor i imi nuk është përfshirë në asnjë nga

pretendimet publike që u bënë e po vazhdojnë të bëhen nga pseudo-portale të caktuara sipas porosive të caktuara, dhe t'u jepet fund shpifjeve, fyerjeve dhe shantazheve në adresë timen dhe të familjes sime", ka thënë ajo. Haradinaj-Stublla u është referuar disa raportimeve nga një media lokale në Kosovë, e cila ka postuar një material ku shihen tre persona, të cilët dyshohet se diskutojnë lidhur me falsifikimin e votave të kandidatëve të subjekteve politike në QNR. Një ditë më parë koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kosovë, Demokracia në Veprim (DnV), i ka bërë thirrje Prokurorit të Shtetit që t'i nisë menjëherë hetimet rreth këtyre dyshimeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur më 4 mars rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit ka shënuar fitore bindëse, duke siguruar 58 ulëse në legjislaturën e re. Sipas rezultetit përfundimtar, Partia Demokratike e Kosovës do të ketë 19 ulëse në kuvend, Lidhja Demokratike e Kosovës 15 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të ketë tetë deputetë. Në afatin 24-orësh për ankesa, pas shpalljes së rezultetit përfundimtar, në PZAP janë dërguar 208 ankesa.



DHJETË VJET QË NGA FILLIMI I DIALOGUT KOSOVË - SERBI

# Dialogu Kosovë - Serbi nuk solli rezultatet e pritura

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë vlerësuar se ky proces nuk ka sjellë rezultatet e pritura. Në dhjetëvjetorin e fillimit të këtij procesi hulumtuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se dialogu i Brukselit ka sjellë disa përfitime për Kosovën. Por, sipas tyre, për këto përfitime Kosova ka bërë edhe shumë kompromise. Ndërsa ish-ministrja për dialog, Edita Tahiri, ka thënë se ky proces ka qenë rruga më e drejtë e cila ka sjellë rezultate për Kosovën, sidomos për integrimin e pjesës veriore në sistemin shtetëror të Kosovës

teknike, si ajo për lëvizjen e lirë, për vulat doganore në mes dy shtetesh, e të tjera, të cilat në shumë raste kishin mangësi në implementim, por për aq sa u zbatuan, kishin një ndikim pozitiv te qytetarët, të paktën sa për ta parë që dialogu ka sens", deklaruar Fetahu. Sipas tij, deri më tani ky proces nuk ka arritur suksesin e dëshiruar. "Sidoqoftë, në një vështrim të përgjithshëm kjo dekadë është karakterizuar me mosimplementim të marrëveshjeve, me tërheqje nga tavolina e dialogut, me bllokada të ndryshme, me rikthim të temave të përfunduara, që në tërësi më shumë ka pasur dështime se arritje. Varësisht me çfarë kuti e masim suksesin, por duke i parë rezultatet në terren, dhe pozicionet shpeshherë armiqësore, dhe më kryesorja

normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve është ende larg, atëherë mund të konkludojmë se sukcesi i dëshiruar nuk është arritur", është shprehur ai. Edhe Violeta Haxholli, hulumtuese në KDI, ka deklaruar për "Epokën e re" se ky proces i ka sjellë Kosovës disa përfitime. "Kur reflektojmë mbi këtë dhjetëvjeçar të dialogut shohim se ky proces i ka sjellë disa përfitime Kosovës, por për të arritur ato Kosova ka bërë edhe shumë kompromise. Disa nga përfitimet janë arritja e marrjes së kodit shtetëror +383 me marrëveshjen e telekomit, pavarësimi energjetik i Kosovës nga Serbia me marrëveshjen e energjisë, konsolidimi i pikave kufitare me anë të marrëveshjes së IBM-it, njohja nga Izraeli me marrëveshjen e Uashingtonit

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 8 MARS** - Kosova dhe Serbia kanë bërë dhjetë vjet që kanë nisur dialogun në Bruksel për ta lehtësuar jetën e qytetarëve të të dy vendeve, por që ende nuk kanë arritur të marrëveshja përfundimtare gjithëpërfshirëse. Monitoruesit e këtij procesi

kanë dhënë vlerësime të ndryshme. Ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se gjatë kësaj dekade të bisedimeve Kosova ka shënuar të arritura, por ka bërë edhe kompromise. Arbër Fetahu, hulumtues në Grupin për Studime Juridike dhe Politike, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se sukseset e këtij dialogu janë larg pritjeve fillestare. "Do të ishte nihiliste të

zhvleftësohej gjithçka çfarë është arritur në këtë dekadë dialog por, shikuar edhe nga prizmi realist, sukseset janë të vakëta dhe larg pritjeve fillestare. Një nga të arriturat kryesore ka qenë mundësia për diskutimin e temave të ndryshme teknike e që kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve të Kosovës dhe atyre serbë. Një sërë marrëveshjesh

## MASH-i jep çmimin vjetor "Shaban Jashari"

**PRISHTINË, 8 MARS (ER)** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka organizuar ceremoninë tradicionale të ndarjes së çmimit "Shaban Jashari", i cili i jepet mësimdhënës të dalluar për kontribut në fushën e arsimit dhe edukimit. Mësimdhënësja e Shkollës së Mjekësisë "Dr. Xheladin Deda", Shemsije Zeqiri nga Mitrovica, këtë vit është nderuar me këtë çmim në shenjë respekti për përkushtimin në punë. Zëvendësministri i Arsimit,

Xhavit Rexhaj, me këtë rast ka thënë se është nder i veçantë që të jetë në mesin e mësimdhënësve të dalluar për ta shënuar festën e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit. Zëvendësministri Rexhaj ka thënë se nuk mund të gjendet një grup tjetër njerëzish më i përshtatshëm sesa mësimdhënësit e dalluar për të shënuar këtë festë të rëndësishme. Ndër të tjera, ai tha se roli i mirëfilltë i mësimdhënësit në veçanti është

kuptuar gjatë vitit të fundit dhe pas një viti të vështirë shkollor mund të thuhet se ia kemi dalë pavarësisht prej sakrificave dhe vështirësive që kemi pasur. Fituesja e çmimit "Shaban Jashari", Shemsije Zeqiri, me këtë rast tha se është e emocionuar pasi ky është çmimi më i lartë për mësimdhënie. Zeqiri tha se do ta vazhdojë punën me përkushtim të madh, ashtu siç ka punuar deri më tani.





etj”, ka deklaruar Haxholli, duke përmendur edhe kompromiset që Kosova ka bërë në këtë proces. “Ndërsa disa nga kompromiset që ka bërë Kosova janë fusnota në vend të Republikës, krijimi i divizionit të apelit me marrëveshjen e drejtësisë duke cenuar kështu sistemin unitar të drejtësisë, si dhe zotimi për të themeluar një asociacion të komunave me shumicë serbe, i cili, me marrëveshjet e 19 prillit dhe 25 gushtit, shkon përtej Kushtetutës së vendit. Po ashtu, pavarësisht prej kompromiseve që ka bërë Kosova, Serbia ende nuk ka ndryshuar qasjen e saj sa i përket statusit të pavarur të Kosovës dhe ende nuk ka një marrëveshje finale me anë të së cilës Serbia e njeh Kosovën dhe e cila përmbull suksesshëm këtë proces të gjatë dialogu”, ka vlerësuar Haxholli.

Ndërsa ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë se procesi ka sjellë rezultate për Kosovën, sidomos për integrimin e pjesës veriore. “Duke qenë kryenegociatore e Kosovës gjatë shtatë vjetësh në dialogun e Brukselit, edhe një herë dua të bëj me dije se dialogu i Brukselit ka qenë në rrugën e drejtë dhe

ka sjellë rezultate për Kosovën sidomos në integrimin e pjesës veriore në sistemin shtetëror të Kosovës duke hequr nga tavolina idetë serbomëdha për ndarjen e Kosovës dhe, po ashtu, ka hapur rrugën zyrtare të integritimit evropian të Kosovës dhe anëtarësime të shumta në organizata rajonale dhe ndërkombëtare”, ka vlerësuar Tahiri.

Sipas saj, procesi u bllokua nga agjenda gjeopolitike e “Serbisë së madhe”. “Mirëpo, kur dialogu i Brukselit po i afrohej fazës përfundimtare, Serbia e bllokoi këtë proces me arsye gjeopolitike për krijimin e ‘Serbisë së madhe’. Veprimet destruktive të Serbisë, me ngritjen e një ‘muri ilegal’ në pjesën veriore të Mitrovicës në dhjetor të vitit 2016 dhe nisjen e një treni ‘ilegal e provokues’ në janar të vitit 2017, nuk ishin provokime të rastësishme. Përkundrazi, këto veprime të rrezikshme paralajmëronin fundin e dialogut për fqinjësi mes shtetesh që zhvillohej në Bruksel dhe krijimin e hapësirës për ide të rrezikshme për ndryshim të kufijve dhe ndarjen e Kosovës që tashmë kishin nisur nëpër takime sekrete”, ka

thënë ajo.

### Qeveria e re pritet ta ndryshojë qasjen ndaj dialogut

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë folur edhe për vazhdimin e këtij procesi. Violeta Haxholli nga KDI-ja ka thënë se pret që qeveria e re ta ndryshojë qasjen në këtë proces. “Po me qeverinë e re pritet një ndryshim sa i përket qasjes ndaj dialogut. Ekzekutivi i ri ka paralajmëruar rivlerësim të procesit dhe marrëveshjeve të dialogut. Po ashtu, kryeministri në ardhje ka deklaruar se dialogu nuk është një nga prioritetet kryesore. Në këtë drejtim ne si KDI mendojmë se dialogu duhet të trajtohet me seriozitet, sepse qeveria ka mandat kushtetues që të merret edhe me politikën e brendshme dhe atë të jashtme dhe këto të dyja nuk duhet të jenë zëvendësime për njëra-tjetrën. Pra, nga qeveria e re dhe kryeministri i ri pritet t’i trajtojë të dyja këto domene me prioritet”, ka vlerësuar Haxholli. Ajo ka bërë me dije se qeveria e re duhet t’i shfrytëzojë rrethanat

e favorshme ndërkombëtare për këtë proces. “Po ashtu, rrethanat ndërkombëtare aktualisht janë të favorshme për Kosovën, sidomos duke pasur në administratën amerikane një president si z. Joe Biden i cili ka deklaruar vetë se ka raporte speciale me Kosovën. Prandaj shteti i Kosovës duhet të përfitojë nga këto rrethana që t’i shtyjë përpara kërkesat e saj ndaj Serbisë dhe dialogut duke pasur parasysh që ka ende shumë çështje që nuk janë adresuar nga ana e Serbisë si kërkimfalja, të pagjeturit, dëmet e luftës, moszbatimi i shumë marrëveshjeve të dialogut etj. Pra, në vend se të ketë rezistencë ndaj dialogut, duhet të ketë lobim të partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht tek administrata amerikane mbi kërkesat e Kosovës ndaj Serbisë”, ka deklaruar Haxholli, duke shtuar se një artikullim i mirë i kërkesave dhe një strategji e mirë lobimi është ajo që duhet të bëjë pala e Kosovës në këtë proces.

Kurse Arbër Fetahu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka thënë se pret një qasje proaktive të qeverisë në këtë proces. “Është mirë të

pritet konstituimi i institucioneve për të parë qartë se si do të vazhdohet dialogu me Serbinë, apo më mirë thënë si do të jetë qasja në këtë proces, për arsye që të mos paragjykojmë pozicione apo veprime që do të mbajë qeveria e re. Sidoqoftë, në aspektin se si duhet të jetë qasja në dialog nga kjo qeveri, atëherë unë pres një qasje proaktive, jo defansive, që nënkupton propozim temash, kërkesa për zbatim marrëveshesh nga Serbia, dhe ngulmim për një rezultat final me njohje të ndërsjellë”, ka vlerësuar ai.

Sipas tij, qeveria e re duhet të përpilojë një platformë të qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta. “Kjo qeveri e ka të gjithë legjitimitetin dhe fuqinë politike e që, ndoshta qeveritë, e tjera nuk e kanë pasur që ta shtyjë përpara këtë proces me qasje serioze. Unë pres që të përpilohet një platformë e qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta, e konsultuar edhe me partitë e tjera parlamentare, që pozicioni i Kosovës të jetë i fortë. Gjithashtu, do të ishte e dëshirueshme një kërkesë për një angazhim edhe më të drejtpërdrejtë të ShBA-së karshi BE-së në këtë proces, dhe Kosova ta luajë rolin përbashkues e jo të shërbejë si përçarëse për këto dy superfuqi”, ka thënë Fetahu.

Kosova dhe Serbia nisën një proces të dialogut më 9 mars të vitit 2011. Në këtë periudhë dhjetëvjeçare u zhvilluan dhjetëra takime dhe u nënshkruan shumë marrëveshje, por ky proces ende nuk prodhoi një marrëveshje finale në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Procesi i dialogut Kosovë - Serbi kishte nisur me bisedimet për çështje teknike, ndërkaq në vitin 2012 kishte evoluuar në bisedime politike, për të kaluar më pas në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me përfaqësim të nivelit të lartë politik ndërmjet kryeministrave dhe presidentëve të të dyja vendeve.

## 212 të shëruar dhe 587 raste të reja me Covid në Kosovë

**PRISHTINË, 8 MARS (ER)** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 813 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 587

raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Dragash një rast (62 vjeç), Gjilan një rast (56 vjeç), Prishtinë një rast (66 vjeç), Skenderaj një rast (66 vjeç), Suharekë një rast (70 vjeç), Viti një rast (65 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 73 635 raste nga 332 713 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1655 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë




shëruar 212 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 62 198 raste, kurse

numri i rasteve aktive është 9 782.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 203 raste,

Prizren 45 raste, Gjilan 39 raste, Gjakovë 31 raste, Fushë-Kosovë 31 raste, Pejë 27 raste, Ferizaj 26 raste, Lipjan 23 raste, Vushtrri 23 raste, Kamenicë 22 raste, Mitrovicë 16 raste, Obiliq 16 raste, Drenas 14 raste, Viti 12 raste, Suharekë 10 raste, Deçan 9 raste, Podujevë 7 raste, Malishevë 6 raste, Skenderaj 6 raste, Kaçanik 5 raste, Istog 4 raste, Novobërdë 3 raste, Dragash 2 raste, Graçanicë 2 raste, Klinë 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me 1 rast komuna e Junikut.

# A ishte fitorja në zgjedhje revolucion elektoral apo truk kibernetik e diplomatik



Milazim KRASNIQI

Fitorja e LV-së dhe Vjosa Osmanit në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 nuk është një fitore e zakonshme, nga ato fitore që sjellin rotacionin e pushtetit, por e vazhdojnë qeverisjen brenda një kornize të ngjashme politike. Në fakt, fitorja e 14 shkurtit i ka elementet e një revolucionit elektoral, i cili e ndryshon jo vetëm qeverisjen, por edhe skenën politike. Pas kësaj fitoreje dërrmuese, partitë konkurruese, LDK-ja, PDK-ja e të tjerat, duhet të shkojnë në remont gjeneral, nëse duan të mbijetojnë e të mbesin në skenë për garat e ardhshme elektorale. Ato janë të dërrmuara dhe tash për tash edhe të çorientuara, jo vetëm nga disfata e rëndë, po edhe nga paaftësia që t'ia gjejnë fillin një rimëkëmbjeje të vërtetë. Ato ende nuk e kanë kuptuar që meqë nuk kanë dashur të ndryshojnë vetë, ka ndryshuar votuesi i tyre, duke ua bërë bllok. Ajo që tashmë shihet, është se skena politike ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme, duke e lënë vendin praktikisht pa opozitë. Por, se sa do të ndryshojë qeverisja, kjo mbetet të shihet. Fitorja bindëse në zgjedhje, asnjëherë nuk është garanci për qeverisje të suksesshme. Ajo është një rrethanë që e mundëson një qeverisje të suksesshme, por se a do të shfrytëzohet ajo rrethanë, varet edhe nga shumë faktorë të tjerë. Në rend të parë varet nga moraliteti i fitores. Si? Nëse fitorja ka ardhur si rezultat i bindjes, motivimit dhe mobilizimit të zgjedhësve mbi një program të qartë dhe të realizueshëm, kjo mundëson edhe realizim më të lehtë të tij. Në atë rast qytetarët e dinë se çka do të bëjë qeveria e re dhe çka pritet të bëjnë ata, për ta ndihmuar qeverinë që ta realizojë programin e premtuar. Ashtu mund të krijohet harmonia ndërmjet fitores elektorale dhe përpjekjes qeveritare, për ta konkretizuar programin e premtuar. Nëse fitorja ka ardhur si rezultat i votës

negative ndaj të tjerëve, ose si rezultat i pritshmërive jorealiste, ose si rezultat i inxhinieringut kibernetik a truqeve diplomatike të ndonjë fuqie politike të jashtme, fitorja në zgjedhje nuk ka garanci se ka moralitet, prandaj ka edhe më shumë vështirësi për zbatimin e programit. Prandaj, varësisht nga përgjigja se çka e ka mundësuar këtë fitore spektakulare të LV-së e Vjosa Osmanit në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, mund të prognozohet suksesi i qeverisjes së fituesve.

Nga sa dihet, fitorja LV/Osmani, nuk është rezultat i bindjes, motivimit dhe mobilizimit mbi një program të qartë e të realizueshëm. Këtu nuk do të analizoj elementë të programit të tyre, as ata elementë që janë kompelmentarë e as ata që ideologjikisht janë të kundërvënë. Mjafton të kujtohet fakti që në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, Albin Kurti e Vjosa Osmani kanë qenë kundërshtarë të fortë, në një garë të ngushtë për postin e kryeministrit. Sheshimi i rivaliteteteve ka ardhur si pasojë e luftës së mbrapshtë në LDK, ku Vjosa Osmani iu mbyll dera drejt postit të kryetares së partisë. Prandaj më parë mund të thuhet se kalimi masiv i votës nga LDK-ja në listën e LV-së, ku mori azil partiak Vjosa Osmani, është votë e reagimit kundër taktikave ekskomunikuese të kreut të LDK-së, i cili në këtë rast u tregua politikisht senilë. Kjo ishte rrethana që shkaktoi kalimin e votuesve nga LDK-ja drejt Vjosa Osmanit, e jo ndonjë pritshmëri e madhe ndaj saj, po thjesht një solidarizim me të. Ndërsa në rastin e Albin Kurtit, elementi dominant vërtet është pritshmëria e lartë e votuesve nga premtimet elektorale të LV-së dhe të vet Kurtit.

Por, mua më duket se ka edhe një element të rëndësishëm në këtë fitore, veçmas në rastin e Kurtit: inxhinieringu kibernetik. LV-ja ka përdorë tash sa vite në mënyrë masive komunikimin në internet, me një agresivitet pothuajse revolucionar. Mobilizimi i të rinjve dhe i bashkatdhetarëve në diasporë me këtë formë komunikimi, ka qenë shumë efikas. Mua më duket se mobilizimi aq spektakular i atyre grupeve sociale, ka elemente nga taktikat që ka

përdorë Kembrixh Analitika, në disa vende të ndryshme, para se të kompromentohej e të shkërmoqej. Dihet se ka pasur raste kur Kembrixh Analitika ka nxitur daljen ose mosdaljen masive dhe fanatike në zgjedhje, gjë që ka qenë përcaktuese në rezultatet të zgjedhjeve. Jo vetëm në rastin e zgjedhjes së Trumpit e në rezultatit e Brexitit.

Bile një rast më tipik ka qenë në Trinidad-Tobago në vitin 2009, ku pati nxitje të të rinjve të një komuniteti për mosdalje në zgjedhje, gjë që mundësoi fitoren e komunitetit tjetër, gjë që ishte synimi strategjik i Kembrixh Analitikas. Në rastin e Kosovës, nxitja ka qenë në kahun e kundërt, pra, dalja masive e të rinjve në zgjedhje. Në esencë nxitja është brenda të njëjtës skemë, që synon të arrijë fitoren e një subjekti. Nuk e di cila firmë ka qenë e angazhuar nga LV-ja për strategjitë elektorale, veçmas në sektorin e komunikimit në rrjete sociale e në mediet e reja, por kushdo që ka qenë, mundet që ka ndjekur disa nga taktikat e njohura të Kembrixh Analitikas që shkaktojnë përmbyesje. Në këtë kontekst, mund të thuhet se dyfishimi i votës brenda një viti, nuk është reagim spontan i votuesve. Është një reagim i stimuluar me overdozë të indoktrinimit politik. Ajo çka mbetet të kuptojmë në të ardhmen është sekush ishte në rolin e toreadorit, që e lëvizë shaminë e kuqe përballë

demit, duke e nxitur të reagojë? Ndonëse analogjia nuk është e plotë, siç nuk është asnjëherë, duket se në rolin e toreadorit ka qenë ish ambasadori Grenell, i cili ka nxitur reagimin e një elektorati të zhgënjyer, të përgjumur, që të zgjohet, të reagojë, të sulmojë. Taktikat e ambasadorit Grenell në mobilizimin e elektorati të përgjumur kundër establishmentit aktual, kanë qenë shumë efikase. Pse e ka bërë? Nuk besoj në atë që thotë Daniel Serveri se gjoja Grenelli është budalla. Mua më duket se ka qenë në rolin që i është dhënë, të toreadorit, që provokon demin e mërzitur dhe të dërrmuar. Nëse është kështu, i bie që Uashingtoni zyrtar nuk ka pasur asnjë alternativë tjetër, për ta çmontuar establishmentin e instaluar të koalicioneve PDK/LDK/AAK, i cili me politikën e veta abuzive dhe shpesh herë të rrezikshme, e ka vënë në siklet administratën e ShBA-së. Kjo ka ndodhur në jo pak raste, që nga mosmenaxhimi i shkuarjeve të të rinjve në Siri e Irak, me arrestimin e pakuptimtë të gylenistëve, me mosratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi, me idetë e rrezikshme për shkëmbimin e territoreve e deri te tentativa për ta zhbërë Gjykatën Speciale. Të gjitha ato mosveprime e veprime, strategjikisht kanë qenë kundër interesave amerikane në Kosovë e në rajon. Prandaj bën vaki është kërkuar një

formulë e panatyrshme për çmontimin e atij establishment: në njërin anë me Gjykatën Speciale e në anën tjetër me diplomacinë arrogante të Grenellit. Nëse rrëzimi i qeverisë Kurti1, ka shkuar në favor të fitores spektakulare të Kurtit në zgjedhjet e 14 shkurtit, kjo që sapo thashë bëhet më e besueshme. Natyrisht, jo për të gjithë, po vetëm për ata të paktët, që e dinë se si funksionojnë skemat e imponimit të ndryshimeve me imponim. Nëse është kështu (kjo është vetëm hipotezë imja) rezulton që segmente të caktuara të diplomacisë e administratës së ShBA-së kanë përdorë taktika të maskuara, që realisht e kanë ndihmuar fitoren e LV-së dhe Vjosa Osmanit. Fakti që Vjosa Osmani ka prejardhje nga LDK-ja dhe që ka kryer një pjesë të shkollimit në ShBA, nuk ka mundur të jetë pa ndikim në atë kombinatorikë, nëse është e atillë.

Pra, fitorja LV/Vjosa Osmani, e cila është bindëse, mund të ketë brenda vetes edhe disa skema për të cilat publiku mund të kuptojë më vonë, ose mund të mos kuptojë asnjëherë. Kjo nuk e zbeh vlerën e fitores së tyre, por mund ta vështirësojë qeverisjen e tyre. Veçmas nëse manipulimi kibernetik ka qenë enorm dhe nëse truku diplomatik ka bërë që pritshmëria e ShBA-së të jetë përtej mundësive të qeverisë së ardhshme.

8 mars 2021



# Shumica e zyrtarëve politikë nuk i ndajnë të hyrat me bashkëshortet e tyre

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA


PRISHTINË, 8 MARS - Lëvizja FOL me mbështetjen e Konrad Adenauer Stiftung (KAS) ka analizuar të dhënat nga deklarimi i pasurisë së zyrtarëve publikë sa i përket posedimit të pasurisë së grave zyrtare publike dhe të grave të zyrtarëve publikë. Për të diskutuar për gjetjet e këtij raporti të ftuar ishin kryeshefja ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore nga Zyra e Kryeministrit, Edi Gusia, drejtoresha ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, Luljeta Demolli, gjithashtu në linjë të drejtpërdrejtë ishte edhe Daniel Braun, drejtor i Zyrës së KAS-it për Kosovë dhe Maqedoni. Drejtoresha ekzekutive e Lëvizjes FOL, Mexhide Demolli-Nimani, ka thënë se qëllimi i këtij raporti ishte të reflektojë mbi kushtet e grave zyrtare publike si dhe gratë e zyrtarëve publikë në deklaratën e pasurisë në emër të të dy bashkëshortëve, por edhe pjesëmarrjen e gruas si pronare në trashëgiminë e dhuruar ose (individualisht) pronë e blerë. "Ky raport përfshinë deputetët e dy legjislaturave të fundit të Kuvendit, kabinetet qeveritare të qeverisë Haradinaj, Kurti dhe Hoti si dhe kryetarët e komunave", ka thënë ajo. Drejtor i Zyrës së KAS-it për Kosovë dhe Maqedoni, Daniel

Braun, ka theksuar se barazia ekonomike është shumë e rëndësishme për t'u arritur në mënyrë që gratë të jenë të barabarta pastaj në të gjitha sferat e tjera.

Alba Jakupi nga Lëvizja FOL ka prezantuar gjetjet e raportit. Sipas saj, në qeverinë Hoti vetëm 36 për qind e ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes, ndërsa 18.5 për qind e zëvendësministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes. "Kjo qeveri ka pasur tri ministre gra, dy nga të cilat kanë pasuri në emër të tyre, ndërsa një nuk ka", ka thënë Jakupi.

Ndërkaq në qeverinë Kurti ajo thotë se 85 për qind e ish-ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes; 50 për qind e zëvendësministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes. "Në këtë qeveri, 50 për qind e ministrave gra kanë pasuri të tyre, ndërsa vetëm 33 për qind e zëvendësministrave kanë pasuri të tyre. Në qeverinë Haradinaj vetëm 25 për qind e ish-ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes, ndërsa 50 për qind e ish-zëvendësministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes. Kjo qeveri ka pasur vetëm një ministere grua, e cila ka pasur pasuri në emër të saj", ka thënë Jakupi.

Edi Gusia, drejtoreshë e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, ka thënë



se, pavarësisht që Ligji për Familjen e njeh pronën e krijuar pas martesës si pronë që iu përket të dy bashkëshorteve, fatkeqësisht ende nuk janë vetëdijësuar ta regjistrojnë pronën në emër të të dy bashkëshortëve. "Më vjen mirë që 55 për qind e kryetarëve të

komunave kanë të regjistruar pasuri në emër të bashkëshorteve edhe pse asnjë grua nuk udhëheq në nivelin komunal", ka thënë Gusia. Ndërkaq drejtoresha në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, Luljeta Demolli, ka thënë se në Kosovë nuk është e

kënaqshme ndarja e trashëgimisë dhe, siç thotë ajo, kjo tregon se ka ende mbetje të patriarkatit në familje dhe institucione. "Ndarja e pasurisë është ndarje e pushtetit, prandaj mund të shihet se në Kosovë ky pushtet nuk u takon të dy gjinive njësoj", ka deklaruar Demolli.

## Mbahet konferenca 'Roli i gruas në institucionet e sigurisë'



PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, të hënën në ambientet e Kazermës së FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë, organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, është mbajtur konferenca "Roli i gruas në institucionet e sigurisë". Pjesë e kësaj konference ishin edhe ish-presidentja Atifete Jahjaga, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, zëvendësministria e Mbrojtjes, Sadika Kofrc, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, Rozafa Ukimeraj, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli dhe oficerë dhe zyrtarë të Ekipit Këshillëdhënës të NATO-s (NALT). Moderuar nga sekretarja Ukimeraj, para vazhimit dhe grave zyrtare dhe ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, fjalime mbi rolin e gruas në institucionet e sigurisë, konkretisht në Ministrinë e

Mbrojtjes dhe FSK-në, mbajtën ministri Quni dhe gjeneral Rama.

Në vazhdim konferenca zhvilloi punimet në formatin interaktiv me komente dhe pyetje nga ana e të pranishmëve adresuar ish-presidentes Jahjaga dhe anëtarëve të tjerë të panelit përkatës.

Ish-presidentja Atifete Jahjaga ka vlerësuar shumë lart rolin e gruas në prosperitetin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore si dhe atë të gruas në veçanti në të gjitha etapat historike, me theks në periudhën e rezistencës dhe luftës për liri, pavarësi dhe demokraci.

Kjo konferencë nga të gjithë u vlerësua e suksesshme, duke përmbyllur punimet me vendosjen e luleve të memoriali "Heroinat", në përkujtim dhe nderim të rreth 20 mijë grave të dhunuara në luftën e fundit në Kosovë.



# Gratë që udhëheqin biznese të vogla përfitojnë nga programi i rimëkëmbjes

Në aktivitetin “Shënimi i 8 Marsit - Dita Ndërkombëtare e Gruas” u bë nënshkrimi i marrëveshjeve me përfitueset e bizneseve të vogla të grave nga programi i rimëkëmbjes ekonomike 2021 - masa 4, faza e dytë. Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka theksuar se gjatë vitit 2020 qeveria ka punuar shumë ta integrojë perspektivën gjinore në masa të rimëkëmbjes ekonomike

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 MARS - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, mori pjesë në aktivitetin “Shënimi i 8 Marsit - Dita Ndërkombëtare e Gruas”, me ç’rast u bë edhe nënshkrimi i marrëveshjeve me përfitueset e bizneseve të vogla të grave nga programi i rimëkëmbjes ekonomike 2021 - masa 4, faza e dytë. Me këtë rast, duke i uruar

të gjitha gratë për 8 Marsin, kryeministri Hoti tha se më shumë se sa festë është ditë që ne të gjithë pa përjashtim shprehim mirënjohjen dhe vlerësimin për kontributin e grave në shoqëri, ekonomi dhe përgjithësisht në zhvillimin social të vendit, mbi të gjitha në stabilitetin e shoqërisë, familjes dhe të shtetit në çdo aspekt. Kryeministri Hoti nënvizoi se gjatë vitit 2020 qeveria ka punuar shumë ta integrojë

perspektivën gjinore në masa të rimëkëmbjes ekonomike, duke ndarë dy milionë euro, prej të cilave një milion euro kryesisht për institucionet e arsimit parashkollor ku kanë përfituar 115 institucione parashkollore në nivel vendi. “Kjo mbështetje besoj nuk ka qenë e rëndësishme vetëm për funksionimin normal të këtyre institucioneve parashkollore, por ka qenë e rëndësishme sepse ne kemi siguruar përmes

## Mbahet ankandi i katërt i letrave me vlerë për vitin 2021

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 15 mars do të mbahet ankandi i katërt për vitin 2021. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 20 milionë

eurosh. “Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (pesë vjet) dhe është tërësisht i liruar nga

tatimi”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave. Sipas këtij njoftimi, për hollësi rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.







# Sindikata e Lotarisë, në pritje të ekzekutimit të pagave

PRISHTINË, 9 MARS - Pas protestës që po mbahej përpara ndërtesës së qeverisë nga punëtorët e Lotarisë për moszekutimin e pagave tash e një vit, përfaqësuesja e Sindikatës e Punëtorëve të Lotarisë së Kosovës, Shpresa Gosalci, është takuar të hënën me ministrin në detyrë të Financave, Agim

Krasniqi.

Gosalci ka bërë me dije se nëse deri në fund të javës nuk ekzekutohen paga do të vazhdohet serish me protesta të tjera. Gosalci ka treguar se ministri Krasniqi u ka premtuar se do t'i shqyrtojë të gjitha mundësitë për të arritur një zgjidhje për punëtorët e Lotarisë.

“U takuam me ministrin e Financave dhe si rezultat i takimit, ai na premtoi se do t'i shqyrtojë të gjitha mundësitë për të arritur një zgjidhje. Se cili do të jetë vendimi, mbetet ta shohim. Afati kohor do të jetë deri në fund të kësaj jave”, u shpreh Gosalci, duke shtuar se për veprimet e tjera, Sindikata do të njoftojë me kohë.



kësaj mase vazhdimësinë e edukimit të vazhdueshëm parashkollor për 6 938 fëmijë dhe u kemi mundësuar familjeve të atyre fëmijëve që të mos shkëputen nga puna e përditshme që bëjnë”, ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se në anën tjetër, përveç kësaj mase, institucionet e tjera kanë ndihmuar gratë në biznes. “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndarë 400 mijë euro për rreth 30 biznese të udhëhequra nga gratë. Kemi dizajnuar masa më specifike përmes vendimeve ekzekutive të qeverisë. Në fund të vitit të kaluar, me organizim të Agjencisë për Barazi Gjinore, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ne kemi ndarë mjete financiare për dhjetë strehimore që janë të licencuara e që ofrojnë mbrojtje specifike për qytetarët e Kosovës, me orientimin tonë që tash këto strehimore të bëhen pjesë e planifikimit të rregullt të institucioneve të qeverisë, jo vetëm përmes financimit ‘ad hoc’, por duke i bërë pjesë të planifikimit të rregullt buxhetor”, është shprehur ai.

Hoti ka theksuar se kjo përkrahje kjo do të vazhdojë edhe më tutje, pavarësisht prej ndryshimeve që mund të ndodhin. “T’i fuqizojmë gratë në ekonomi, ta rrisim

pavarësinë financiare dhe ekonomike të grave dhe ta eliminojmë plotësisht dukurinë negative, që është dhuna ndaj grave në familje dhe në shoqëri”, ka deklaruar Hoti. Ai ka thënë se gjatë qeverisjes së tij kanë dhënë evidencë të mirë sa i përket integritetit të politikave gjinore. “Kemi vendosur një standard që duhet të mirëmbahet më tutje, të integritetit të politikave gjinore, të gjithë politikat pa përjashtim, të zbatimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, që është në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe në respektim të synimeve të mijëvjeçarit. Mua më vjen shumë mirë që e përmbylim këtë program sot edhe me një informatë të mirë në bazë të evidencës që ka nxjerrë Agjencia për Barazi Gjinore ku, sipas të dhënave të sistemit të Kombeve të Bashkuara që quhet ‘Gjurmuesi Global Gjinor në Kundërpërgjigje ndaj Covid-it’, Kosova është në mesin e 15 vendeve që kishte masa për sigurimin ekonomik të grave gjatë kohës së pandemisë, krahas shteteve më të zhvilluara të botës siç janë: Kanadaja, Belgjika, Italia, Sllovenia, ShBA-ja dhe disa prej vendeve në regjion”, është shprehur kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti.

## Gastronomët paralajmërojnë protesta



PRISHTINË, 8 MARS - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka insistuar se në momentin që masat aktuale mund të ndryshojnë, do të ketë organizim të protestave.

Gastronomët me anë të një njoftimi për media kanë theksuar se nuk kanë ndërruar mendim në lidhje me organizimin e protestave të mundshme. “Theksojmë përsëri

se në momentin që masat aktuale mund të ndryshojnë, do të ketë organizim të protestave”, është thënë në njoftimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

Përsiatje politike

# TRIADA E KOSOVES

## - Shqipëria dhe pranvera e vitit 1981 në Kosovë

**Shkruan: Bedri ISLAMI**

### Fillesa

Mbrëmja e 11 marsit 1981 dukej se do të ishte e zakonshme, në shumëllojshmërinë e të tjerave që largohen pa lënë shenjën e tyre. Çuditërisht, një mbrëmje e butë, me errësirën që ka rënë në qytetin studentor të Prishtinës, ku vetëm një sy i stërvitur mund të vinte re se kishte një lëvizje më të dendur se zakonisht dhe se në dyert e godinave të fjetjes dhe pranë mensave, kishte më tepër studentë se në mbrëmjet e tjera të marsit.

Thellimi i marsit duket se po ikte.

- Idetë e marsit po ikin, - tha një student i filozofisë. Befas, kur dukej se iku edhe një natë, gjithçka ndryshoi. U dëgjuan zëra të zhurmshëm, pastaj përplasje dyersh dhe ndonjë krismë e rrallë që ngjante si thyerje pjatash dhe, ashtu si fryn befas një erë e

furishme stuhie, njerëzit dolën në sheshe dhe filluan të flasin me zë të lartë. Fillimisht nuk kuptohej se çfarë po ndodhte. Gjithçka dukej si një lëvizje amorfe, e lindur befasisht dhe, si të gjithë gjërat e befta, edhe ajo ishte e rrëmujshe. Por, ndërsa zërat ngriheshin gjithnjë e më tepër, gjërat po organizoheshin përherë e më mirë.

Dritat në konviktet përreth po ndizeshin përherë e më shumë dhe u duk se u krijua një qiell tjetër, që edhe kishte lidhje me qiellin e ndriçuar, por edhe paralajmëronte se tashmë bëhej fjalë për diçka më të madhe nga ajo që po ndodhte.

Sheshi po mbushej dhe, kur hapësira nuk i zinte të gjithë ato që po mblihdeshin jashtë, atëherë studentët iu drejtuan rrugëve të Prishtinës. Pra, kur u bënë shumë, kur sheshet e korpusit studentor nuk ishin të mjaftueshme, ata dolën në rrugë.

Deri atë moment, ata ishin studentë që protestonin, por, kur dolën jashtë hapësirës universitare, ata morën përsipër shumë më tepër. Nisën rrugën drejt kryengritjes, ndonëse nuk ishin ende kryengritës. Të tillë ata do të bëheshin disa ditë më pas, më 1 dhe 2 prill, duke

pasur si mesore 26 marsin. Katër ditët që do të ndryshonin përjetësisht fatin e Kosovës. E bashkë me të, do të sillnin ndryshime të mëdha në shtetin amë - Shqipërinë.

Gjithçka që kishte ndodhur deri atë dite kishte qenë parapërgatitje. Ajo që do të ndodhte pas saj do të ishte lufta.

Nëse nuk do të kishte qenë viti 1981, Kosovës do i kishte munguar dhe tetori e nëntori i vitit 1989. E, nëse nuk do të kishte qenë ky i fundit, vështirë se do të vinte pranvera e marsit 1998.

Ka një lidhje të hershme mes tyre. Ajo që ndodhi në vitin 1981 solli përgatitjen për luftën e ardhshme. Në mars 1981, studentët dhe njerëzit e zakonshëm veshën uniformat e luftëtarëve, por luftëtarë nuk u bënë. Ishte momenti kur e dinin se me cilët do të ndesheshin, por nuk e dinin ende se si. Sublimja ishte mbjell, por nuk ishte rritur. E rëndësishme që nuk humbi një brez luftëtarësh.

Shpeshherë, guximi ka bërë punë më të mëdha se sa vetë lufta e nisur para kohe. Guximi për të mbajtur brenda vetes çastin e duhur është më sublim se disa armë në çastin e gabuar.

Viti 1981 ishte çasti i duhur për

të nisur një rrugëtim të gjatë, thuajse 20-vjeçar, dhe shumë nga ata, që e filluan, ishin edhe në përfundimin e saj. Të bësh luftë 20-vjeçare nuk do të thotë të jesh vetëm trim, por edhe i mençur e i duruar.

Njëri prej tyre, Adem Jashari, në vitet e mëpasshme, do të tregonte me pak fjalë gjithë filozofinë e kësaj lufte, që gjithkënd tjetër, veç idealistëve, do të kishte rraskapitur: "Ne mund të bëjmë edhe një aksion në javë, por nuk jemi kaçakë të panjohur. Dikush duhet t'i marrë përsipër aksionet tona. Duhet një strukturë drejtuese dhe koha është tani. Lufta e kaçakëve është e bukur, por shter shpejt. Ajo fillon me rrëzue një qeveri dhe vazhdon me sulmue depo drithërash apo ndonjë milic".

Kryengritja do të jetë e pranishme në tre këndet e një lëvizje që shumë herë nuk ka pika të tjera të përbashkëta takimi, dhe, herë të tjera, do të duket se janë në të njëjtën linjë.

Këndi i parë i saj është qendra studentore e Universitetit të Prishtinës.

Çfarë po ndodh aty?

Çfarë po ndodh jashtë saj?

A kanë lidhje ngjarjet brenda këtij korpusi me gjithë zhvillimin e Lëvizjes

Kombëtare Shqiptare në Kosovë?

**Është kauza e drejtë ajo që shenjtëron deri edhe luftën! / Friedrich Nietzsche**

Pyetja e parë që është bërë gjithnjë është: përse pikërisht viti 1981 dhe pranvera e tij? A nuk kishte një kohë tjetër, ta zëmë viti 1968, kur në Kosovë kishin shpërthyer protesta të përgjithshme, të cilat sollën edhe Statusin e Autonomisë së Kosovës? A nuk mund të kërkohej, që në atë vit, ajo që po kërkohej në vitin 1981: Kosova - Republikë?

Përgjigja më e saktë e kësaj pyetje është dhënë nga politologu më i shquar i Kosovës, Ukshin Hoti.

Ukshin Hoti e quante vitin 1981 nyje, zgjidhja së cilës e mundësonte lëvizjen e drejtë të gjërave dhe të proceseve. Ai shpjegon:

Kritika të tjera, subjekte të tjera të ndrydhura e të pandrydhura, natyrisht do të pyesin me të drejtë - përse pikërisht viti 1981? Përse jo ndonjë vit tjetër, p.sh. viti 1968, apo edhe ndonjë vit i mëhershëm, të mos ishte nyja pa zbërthimin e së cilës nuk do të ecej përpara? Dhe, përgjigja mund të duket arrogante, por



në esencë e saktë: sepse vitet e tjera nuk e ndryshuan historinë. Të gjitha vitet i ndihmuan zhvillimit të historisë. Do të thoshim se vitet e tjera i ndihmuan akumulimit të proceseve, rritjes së kuantitetit, por kërcimin kualitativ, vetë shndërrimin e kuantitetit në kualitet, e bëri vetëm viti 1981. Jo se ishte një vit mrekullibërës, por, sepse pikërisht në atë vit ishin pjekur të gjitha kushtet, ishin akumuluar të gjitha proceset, ishin arritur të gjitha nivelet për shndërrimin e kuantitetit në kualitet dhe rastësisht i ndrydhi subjektet, që nuk deshën të pajtoheshin me ndrydhjen. Po të ishin pajtuar me ndrydhjen, viti 1981 do të kalonte njësoj sikurse edhe vitet e tjera.

Edhe kundërgoditja e pushtetit do të ishte më e ashpër se asnjëherë tjetër, natyrisht jo sa ajo e vitit 1948. Në periudhën 1944 - 1947, në Kosovë, do të vriteshin 39 mijë shqiptarë, duke nisur që nga figura, do të thosha, mitike, të qëndresës, si Shaban Polluzha, Mulla Idrizi, e deri tek hartuesit e drejtuesit e Konferencës së Bujanit, ku ishte sanksionuar dëshira e shqiptarëve të Kosovës për t'u bashkuar me Shqipërinë, si Xheladin Hana dhe Ymer Berisha.

Pas vitit 1981 do të ketë goditje masive. Gjer në vitin 1989, kishin përjetuar kontaktin e afërt të llojit "policor", d.m.th ishin keqtrajtuar nga policia rreth 584.373 veta, përafërsisht një në katër shqiptar.

Shumë nga ish të burgosurit politikë të atyre viteve unë i kam njohur nga afër. Jam habitur nga dëshira e tyre, do të thosha etja, për çdo lloj diturie, sidomos për shoqërinë, filozofinë, politikën, artet e historinë. Shpeshherë, më është dukur se miqësia e tyre kishte një lloj misteri që unë nuk e shpjegoja dot. Habitesha, në fillim, se përse në burgjet serbe, ku ata kishin gatitur miqësinë e tyre, u lejoheshin libra në gjuhën shqipe, por kurrë lapsa. Pra, mund të lexonin, por jo të mbanin shënime. Si rrjedhojë, shumë prej tyre ishin të aftë, edhe pas shumë viteve, të recitonin vargje të shumta të Mjedës, Migjenit apo Fishtës; zelli i tyre kishte qenë i pafund, ashtu si edhe aspirata për të bërë pjesën e tyre të historisë. Duke qëndruar gjatë me ta, teksa me jo pak syresh u bëmë miq të afërt dhe bashkëpunëtorë, mësova se shumë prej tyre kishin qenë studentë, të diplomuar apo që i kishin ndërprerë studimet pasi i kishin burgosur. Jo pak vinin nga zonat rurale të Kosovës. Kishte mes tyre edhe punëtorë të të gjitha fushave,

por njëjtë, njerëz të ditur, dhe, thuajse të gjithë kishin kaluar në seanca të gjata torturash të rënda.

Nuk e kuptoja, ose më saktë, nuk doja ta kuptoja, se si pyetjeve që kishin bërë këta njerëz në sallat e gjyqeve të zgjatura, sidomos pyetjes, "përse Kosova nuk mund të jetë republikë brenda kuadrit të federatës", jo vetëm që nuk u ishte dhënë kurrë përgjigje, por për këtë ishin quajtur irredentistë, si shumica e tyre, në të vërtetë, ishin, kundërrevolucionarë, e armiq të bashkim -vllaznimit. Por askush nuk kishte hedhur dritë mbi paqartësinë e tyre: përse nuk e kishin pasur këtë të drejtë?

Përgjigjen, së pari, ata e kishin kërkuar nga autoritetet shqiptare në Kosovë - nuk kishte marrë një prej përgjigjeve që prisnin. Pastaj e kishin kërkuar nga gjykatat që i dënonin dhe as aty nuk kishin marrë gjë tjetër, veç dënimit. E kishin kërkuar nga historianët e Kosovës, por kishin gjetur vetëm belbëzime dhe rrallë shumë rrallë u ishte qetësuar shpirti me të vërtetën. E kishin kërkuar nga shkrimtarët e tyre, mirëpo, as aty, nuk kishin gjetur hapësirën e duhur, përkundrazi, ndonjë si A.P. i kishte bërë titull me të madhe se, nuk i duam librat nga Shqipëria, se janë dogmë. Në fund, e kishin kërkuar nga gardianët, që ishin po ashtu shqiptarë, dhe që i rrihnin egërsisht, ndërsa eprorët serbë qëndronin në karrige duke parë këtë "ndeshje" brenda llojit.

Ukshin Hoti do të ishte e para përgjigje shpresëdhënëse. Ish ministri i jashtëm i Kosovës, që pasi kishte lënë detyrën, kishte studiuar dhe ishte specializuar në Harvard, kishte vendosur të qëndronte pranë tyre. Këto djem, shpeshherë të quajtur "kundërrevolucionarë", ai i kishte parë në aksion. Kishte qenë në afërsi të tyre, e ndonjëherë edhe mes tyre dhe milicisë. I qetë, serioz, me pamjen e një njeriu të panatyrshëm, sytë e të cilit shikonin thellë, ndërsa fjalën e kishte elokumente dhe të kuptueshme deri në palcë. Ukshin Hoti kishte soditur fytyrat e "nxira" nga "betejat", të zbehura nga lodhja dhe të kuqura nga përplasjet. Sytë e përplotur nga gazi, por edhe nga dhembja. Do të ishte ndër të parët, e ndoshta krejt i pari, që nuk i kishte menduar asnjëherë si armiq, të indoktrinuar, apo si kundërrevolucionarë. Kishte fituar përshtypjen e një mllefi të përgjithshëm, të shkaktuar jo vetëm nga momenti aktual, por edhe nga tërë historia.

Nuk e kam takuar asnjëherë



Ukshin Hotin, por miqtë e tij ishin dhe janë edhe miqtë e mi. Si të thuash, e kam njohur përmes shikimit të miqve të tij, sidomos të Bislim Elshanit, kryeredaktorit të gazetës "Zëri i Kosovës", që kishte qenë bashkëpunëtori i tij i afërt. Jam në një mendje me të që thoshte se, në vitin 1981, u vetlind Kosova. Në shtëpi kam ende një foto të tij, në formatin e atyre të një pasaporte, ku ka shkruar me dorën e tij gjeneralitetet, dhe të cilën ia kishte dhënë Fehmi Lladrovci për përgatitjen e një pasaporte. Sepse, veç të tjerave, Ukshin Hotit i ishte ndaluar edhe e drejta e lëvizjes. Njëjtë, si miqtë e tij, të burgosur, të cilët, edhe kur i kishin kërkuar t'i ndërpriste përpjekjet nuk e kishte bërë. Do të jetë i burgosur me to, gjatë, shumë gjatë, dhe, vetë zhdukja e Ukshin Hotit, kur lufta po përfundonte, ishte sinjali i parë se paqja do të ishte e vështirë dhe se do të rëndohej nga mungesa e tij.

\*\*\*

Në mbrëmjen e 11 marsit 1981, nga Qendra Studentore në Prishtinë, një masë e madhe njerëzish, shumica studentë, ishin nisur drejt qendrës së kryeqytetit. Rrugës iu ishin bashkuar të tjerë, të cilët, edhe pse e dinin se kjo lëvizje do të kishte pasojat e saj, përsëri e kishin parë më të arsyeshme të ndodheshin aty. Një eskortë e madhe policësh u ishte vënë prapa, disi të habitur nga kjo që po ndodhte, por edhe të heshtur, pasi ende shumica e tyre ishin të kombësisë shqiptare dhe e kuptonin krejt mirë se çfarë kërkonte ajo masë njerëzore, që po lëvizte drejt qendrës. Askush nuk e dinte se disa qindra metra më tej, një masë tjetër e madhe, por kësaj here milicë, shumica e tyre të kombësive të tjera jugosllave, po priste. Aty ku rruga fillon e zbret dhe ngushtohet për një çast, do të ndesheshin me

autoblindat e para dhe me policë të armatosur. Ndashja mund të ishte e çdo kohe, një mur i armatosur ishte ngritur para tyre, milicët kishin vendosur maskat kundërgaz, armët ishin të hequra nga supet, e megjithatë asnjë nga studentët nuk po tregohej i dhunshëm. Ishte një ndeshje në fillimin e errësirës mes dy skajeve të një litari, që, ndërsa vërvitej në këmbët e një populli, në fakt ishte përgatitur për t'i zënë frymën përfundimisht atij.

Gjithçka rreth tyre ishte e frikshme, por ata nuk kishin frikë!

Shumë vite më vonë, kësaj here në një fshat të shtrirë në kodrinat rreth Kërçovës, në Zajas, pikërisht asaj dite kur po hidheshin themelet e një banese të re, të Ali Ahmetit, dhe data ishte 20 prill, ditë që jo rastësisht përkonte me ditëlindjen time, do të flisnim gjatë me të për shumë gjëra e, mes të tjerave, edhe për vitin 1981. (Vijon)

## Universiteti 'Kadri Zeka' shënon tetëvjetorin e themelimit

GJILAN, 8 MARS (ER) - Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka shënuar tetëvjetorin e themelimit. Me këtë rast, rektori i këtij universiteti, Bajram Kosumi ka shpalosur të arriturat e Universitetit "Kadri Zeka", bashkëpunimet e realizuara deri më tani, si dhe për planet që kanë për qëllim rritjen e cilësisë në mësim. Rektori Kosumi ka thënë se viti 2020, sado i rëndë që ishte për shkak të Covid 19,

për UKZ-në ishte viti me i suksesshëm universitar. Kosumi ka falënderuar të gjithë për kontributin rreth zhvillimit të universitetit, njëkohësisht i ka ftuar ta vazhdojnë punën e përbashkët në zhvillimin e mëtutjeshëm të UKZ-së. Me rastin e tetëvjetorit të themelimit të UKZ-së, rektori Kosumi ka ndarë mirënjohje për kontribut akademik për vitin 2020 për profesorët e këtij universiteti.



## Komuna e Prishtinës ndihmon familjet që kanë nevojë



PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se nga sot kjo komunë ka filluar shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe familjet e izoluar për shkak të infektimit me

Covid. Në profilin e vet në "Facebook", Ahmeti ka shkruar se ndihma përfshinë edhe familjet nga komunitetet pakicë dhe familjet që kanë dërguar kërkesën për ndihmë te Drejtoria për Mirëqenie Sociale. "Prej sot kemi filluar shpërndarjen e pakove

ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale, familjet e izoluar si pasojë e infektimit me Covid, familjet nga komunitetet pakicë dhe familjet që kanë dërguar kërkesën për ndihmë te Drejtoria për Mirëqenie Sociale", ka shkruar Ahmeti.

## Komuna e Ferizajt ndalon tregtimin e masës drusore në tregjet ilegale

FERIZAJ, 8 MARS (ER) - Me vendimin e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, që nga data 15 mars nuk do të lejohet tregtimi i masës drusore në tregjet e deritanishme ilegale të masës drusore, përveç në hapësirën e përcaktuar pranë Tregut të Kafshëve në Ferizaj.

"Njoftohen shitësit e drunjve se Inspektorati i Komunës tashmë është në terren për të njoftuar mbi këtë vendim dhe se nga data e lartcekur, të gjithë shitësit në tregjet ilegale, kudo në territorin e Ferizajt, do të ndëshkohen sipas legjislacionit në fuqi", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.



## Galeria e Arteve në Gjakovë pasurohet edhe me veprat e piktores Bardha Ferizi-Buza

GJAKOVË, 8 MARS (ER) - Në ditën Ndërkombëtare të Gruas, Galeria e Arteve në Gjakovë pasurohet edhe me veprat e piktores Bardha Ferizi-Buza. Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, i cili hapi zyrtarisht ekspozitën, ka falënderuar Bardhën që zgjodhi Gjakovën për t'i paraqitur punimet artistike të saj. Ndërkaq Erzen Vala, kryetar i Shoqatës së Artistëve të Artit Figurativ, ka thënë se Bardha

është unike, punimet e saj janë të veçanta dhe kushdo që përzgjedh t'i ketë në ambientet e veta, nuk gabon sepse zgjedhin vlerën. E vet Bardha, që është bijë e Gjakovës, ka falënderuar komunën dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për mbështetjen jo vetëm individuale, por përmes hapjes së Galerisë së Arteve mbështetjen e të gjithë artistëve të artit figurativ. Ekspozita "Lulet e marsit" do të jetë e hapur për tridhjetë ditë.



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**



ÇMIMI: 5.99 €



**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.



4<sup>99</sup> €

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Shabani me plot mungesa publikon listën kundër Austrisë

PRISHTINË, 8 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave, Agron Shabani, ka publikuar të hënën listën për ndeshjet kualifikuese në Austri. Kosova nuk ka luajtur ndeshje vitin e kaluar për shkak të anulimit të garave si pasojë e koronavirusit. Tani do të paraqitet në fazën e parë kualifikuese për Botërorin 2021. Kosova është në grupin e katërt së bashku me Austrinë dhe Italinë. Ndeshja me Austrinë do të zhvillohet më 19 mars, ndërsa ajo me Italinë më 20 mars. Ndeshjet luhen në Maria Enzersdorf në Austri. Dy të parët në grup avancojnë tutje, ndërsa synim i Kosovës është pozita e

dytë. Shabani, megjithatë, nuk do të mund të llogaritet në shumë lojtare bartëse. Kryesisht për shkak të lëndimeve mungojnë lojtaret e rëndësishme si Leonora Demaj, Albana Arifi, Njoma Zogaj, Pashke Marku, Sara Rexhepi e disa të tjera. Mirjeta Bytyqi është në listë, por ajo vetëm në verë e fiton të drejtën që të luaj për Kosovën në ndeshjet zyrtare. Për herë të parë është ftuar motra e Mirjetës, Mërgime Bytyqi. Për herë të parë është ftuar edhe Kristina Ukaj, portierja që, së fundi, është pajisur me pasaportë të Kosovës. Debutimin në ndeshje zyrtare do ta bëjnë motrat Marigona e




### Lista e hendbollisteve

Njomza Kelmendi, Elma Kameri, Mirela Gjokokaj, Yllka Shatri, Fitore Aliu, Arlinda Hajdari, Albina Rugova, Aurora Shehdadi, Aida Stagova, Kristina Ukaj, Veronika Kastrati, Mirjeta Bytyqi, Marigona Hajdari, Mërgime Bytyqi, Suzana Ujkiq, Meltem Ylberi.

Arlinda Hajdari që në fund të vitit 2019 ishin paraqitur në një turne në Antalia. Albina Rugova, Yllka Shatri, Aurora Shehdadi dhe Suzana Ujkiq janë ftuar nga Istogu. Ftesë mori edhe Njomza Kelmendi e Vushtrrisë dhe Aida Stagova e Prishtinës. Janë ftuar edhe lojtaret: Mirela Gjokokaj, Elma Kameri, Fitore Aliu, Veronika Kastrati e Meltem Ylberi. Përkundër mungesave, vashat "dardane" do të japin më të mirën me synim për të avancuar në raundin tjetër të eliminatorëve. Në shtabin teknik të selektorit Shabani janë Faruk Shala e Valbona Rudaku. Grumbullimi i hendbollisteve bëhet më 12 mars në Istog.

## Katër klube ndjekin çerekfinalen

Juventusit synon përmbysjen e rezultatit nga ndeshja e parë kundër Portos (2-1) dhe kualifikimin në çerekfinale. Kualifikimin në këtë fazë e synon dhe Borussia Dortmundi që e mposhti Sevillan në ndeshjen e parë (3-2)



TORINO, 8 MARS - Kampion në fuqi i Italisë, Juventusit dhe kampioni i Portugalisë, Porto, sonte e zhvillojnë ndeshjen kthyesë në Ligën e Kampionëve, me synim të sigurimit të kualifikimit në çerekfinale të kësaj gare. Porto e fitoi ndeshjen e parë me rezultat 2-1, kurse tash synon ta ruajë këtë epërsi në ndeshjen kthyesë që do të zhvillohet sonte (e martë) në Itali.

Ndërsa "Zonja e Vjetër" do të japë maksimumin që ta përmbysë rezultatit e ndeshjes së parë dhe ta vazhdojë rrugëtimin në garën më të fortë

në futboll. Juventusit në këtë ndeshje i mungon Paulo Dybala që është i dëmtuar, ndërsa Rodrigo Bentancor ka dalë pozitiv me Covid-19. Do të mungojë edhe mbrojtësi Danilo. Ndërsa në skuadrën portugeze mungon Memba, kurse mund të mungojnë edhe Pepe, Corona dhe Marcano. Borussia Dortmundi, pas fitores në ndeshjen e parë ndaj Sevillës në Spanjë (2-3), synon të kualifikohet në çerekfinale. Skuadra gjermane është favorite për të kaluar në fazën tjetër falë paraqitjes së shkëlqyer që pati muajin e

kaluar në ndeshjen e parë. Në anën tjetër, Sevilla, pavarësisht prej formës jo të mirë, synon të "hakmerret" për humbjen në ndeshjen e parë dhe të triumfojë në këtë ndeshje për ta siguruar kualifikimin më tutje. Vendësit do të jenë pa Axel Witsel, Marcel Schmelzer dhe Manuel Akanji, kurse në dyshim janë Giovanni Reyna, Jadon Sancho dhe Raphael Guerreiro. Mysafirët mungesën e vetme e kanë Aleix Vidal.

### TË MARTËN TAKOHEN:

Juventus - Porto (1-2)  
Borussia Dortmund - Sevilla (3-2)

## Albin Tahiri fiton normën olimpikë edhe në disiplinën e sllallomit

PRISHTINË, 8 MARS - Albin Tahiri ka fituar normën olimpikë edhe në disiplinën e sllallomit të skijimit alpin për Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Tahiri fitoi normën falë rezultatit të arritur në garën e Rogllas së Sllovenisë. Ai doli i 40-ti me kohë 1:36.17 minuta pas dy lëshimeve, ndërsa fitoi 123.19 pikë të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë që ishin të mjaftueshme për t'i kompletuar rezultatet e nevojshme për normë olimpikë. Pjesëmarrës në garë ishin 79

garues, ku 35 nuk e përfunduan njërin nga dy lëshimet. 32-vjeçari javën e kaluar e fitoi normën olimpikë edhe në disiplinën e sllallomit të madh. "Pas sllallomit të madh, me rezultatit e sotëm kam kompletuar kriteret olimpikë edhe në sllallom. Prej tani fokusi im do të jetë në disiplinën e shpejta si super sllallom të madh, kombinim alpin dhe lëshim", ka thënë Tahiri për Komitetin Olimpik të Kosovës. Në sllallom normën olimpikë e ka fituar edhe Arbi Pupovci.



## FBK-ja nominon Linda Shalën për kryetare të KOK-ut

PRISHTINË, 8 MARS - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) të hënën, më 8 mars, e ka zyrtarizuar nominimin e nënkryetares së Bordit të FBK-së, Linda Shala, për

kryetare të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Me këtë nominim Federata e Basketbollit e Kosovës e fillon fushatën e FBK-së për 8 mars, Ditën Ndërkombëtare

të Gruas në kuadër të FIBA Europe Girls Program, njëherësh kampanjës "Her World, Her Rules". Kjo fushatë synon t'i motivojë vajzat për t'u marrë me

basketboll dhe ndërgjegjësoi opinionin për ta përkrahur sportin e vajzave në përgjithësi dhe fuqizimin e gruas në veçanti.

## Hearn: Joshua do t'i tregojë vendin Furyt në përballjen e shekullit

LONDËR, 8 MARS - Eddie Hearn, promotori i njohur i boksit, njëkohësisht menaxheri i boksierit, britanik Anthony Joshua, u shpreh se brenda qershorit do të zhvillohet dueli i unifikimit të titujve kampionë bote në peshën e rëndë. Përballë Joshuas në këtë sfidë do të jetë i

pamposhturi Tyson Fury, një përballje e madhe mes dy boksierëve britanikë që pritet me interes nga fansat në gjithë botën. Sipas Hearn, Joshua po stërvitet fort për këtë sfidë. "Unë e njoh mirë Joshuan dhe ai mendon vetëm për këtë duel, për këtë sfidë ndaj Furyt. Ai po punon sipas një

plani për ta mundur Furyt në këtë përballje dhe të bëhet kampion i padiskutueshëm i botës në peshën e rëndë. Kjo mund të jetë ndoshta sfida më e madhe e historisë së boksit", ka thënë ai. "E pëlqej shumë punën që Joshua është duke bërë, përpjekjet e tij për këtë sfidë, mënyra se si po

përgatitet, fizikisht e psikologjikisht. Do të jetë një sfidë e madhe, pasi edhe Fury është një boksier fantastik. Jam i sigurt se edhe Tyson po stërvitet fort. Gjithsesi, mund t'ju konfirmoj se Joshua do t'i tregojë vendin Furyt në këtë përballje", u shpreh Eddie Hearn.



## Qerimi: Japim maksimumin ndaj Rumanisë

Prishtinë, 8 mars - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka vazhduar përgatitjet për ndeshjen e së mërkurës ndaj Rumanisë. Hendbollistët tanë kanë zhvilluar të dielën dy stërvitje nën urdhrat e selektorit të ri, Bujar Qerimi. Përzgjedhësi Qerimi është i kënaqur me mënyrën se si po zhvillohen përgatitjet. "Puna është duke ecur si duhet, ashtu si e kemi menduar. Kemi disa probleme të vogla me lëndime dhe, po ashtu, pandemia ka sjellë probleme. Disa lojtarë nuk kanë stërvitur shumë dhe si duhet. Si pasojë e kësaj kanë lëndime të vogla. Po përpigemi t'i pushojmë për të qenë të gatshëm që t'i bëjnë ballë Rumanisë, përkatësisht



që ta bëjmë lojën më të mirë të mundshme. Përballë e kemi një shtet që hendbollin e ka ndër sportet më të mira. Lojtarët janë të vetëdijshëm se duhet të japin më shumë se që

pritet prej tyre për të nxjerrë rezultat pozitiv", ka thënë Qerimi. Ai ka treguar se fillimisht synohet stabilizimi i ekipit dhe në afat të shkurtër të bëhet hapi para.

## Skuadra e LeBronit triumfon në All Star Game

ATLANTA, 8 MARS - Skuadra LeBron Jamesit triumfon bindshëm në All Star Game. Më të mirët e Perëndimit iu imponuan 170-150 rivalëve të tyre të Lindjes në përballjen më spektakolare të vitit që u zhvillua në "State Farm Arena" të Atlantës. Tre ishin protagonistët e mëdhenj të sfidës: Giannis Antetokounmpo, i cili fitoi çmimin MVP të ndeshjes falë një performace të shkëlqyer prej 35 pikësh, Stephen Curry dhe Damian Lillard. 28 pikë për "ylin" e Warriosit dhe 32 për më të mirin e Blazers, të cilët realizuan nga tetë trepikësha secili. Garat, që tradicionalisht janë zhvilluar të shtunën, u fituan: "Skills Challenge" nga Domantas Sabonis dhe ajo e gjuajtjeve për tri pikë nga Steph Curry, nuk pati rivalë, raporton "Supersport". Siç ndodh zakonisht në All Star Game, të dyja skuadrat u dhanë



përparësi që në fillim veprimeve spektakolare në sulm. Sidoqoftë, skuadra e LeBron Jamesit, falë një Giannis Antetokounmpo të papërmbajtshëm dhe një snajperi si Steph Curry, u shkëput plot 20 pikë në përfundim të periodës së dytë. Gjatë pushimit u zhvillua gara e zhytjeve, në të cilën triumfoi Anfernee Simons. Ekipet u kthyen në fushë për pjesën e

dytë të ndeshjes, por muzika nuk ndryshoi. Damian Lillard u ngrit në katedër duke qenë i saktë në disa gjuajtje radhazi për tre, që nuk e lejua skuadrën kundërshtarë që të afrohej, duke ruajtur distancën prej 20-pikësh. Në periodën e fundit, skuadra LeBron vazhdoi të shënonte në vazhdimësi, duke kapur në fund kuotën e 170 pikëve.

### SHKURT

#### Federeri: Më duket vetja si debutues

Pas 14 muajsh pushim, Roger Federeri do të rikthehet në fushë këtë javë, ku do të luajë në turneun e Dohas. Zvicercani do të luajë në raundin e dytë, një rikthim që pritet me padurim dhe interes si nga vetë tenisti ashtu edhe fansat e tij. "Një ndjesi e çuditshme rikthimi në fushë. Kam më shumë se një vit që nuk udhëtoj për të luajtur në një turne. Më duket sikur do të debutoj në këtë sport, ku kam më shumë se 20 vjet që luaj", ka thënë Federeri. "Ju faleminderit të gjithë për mbështetjen tuaj, kam nevojë në këtë rikthim", ka shtuar Federeri, që këtë vit do të mbushë 40 vjeç. Ai synon të triumfojë në Wimbledon dhe Lojërat Olimpikë "Tokio 2020".

#### City në garë për Mbappen

Manchester City ka hyrë në garë për yllin e PSG-së, Kylian Mbappe. Mediat angleze kanë raportuar të hënën se drejtuesit e Cityt mund ta përballojnë blerjen e kartonit të Mbappes. Ylli francez nuk ka vazhduar ende kontratën me PSG-në, e cila i skadon në vitin 2022. Për Mbappen interesim të vazhdueshëm kanë shprehur edhe Real Madridi dhe Liverpooli. 22-vjeçari ka kontratë me PSG-në deri në vitin 2022. Këtë sezon në të gjitha garat ka shënuar 25 gola dhe nëntë asistime.

#### Guardiola: Ndaj Unitedit luajtëm më mirë se me West Hamin, por humbëm

Manchester Unitedi e mposhti Manchester Cityn (2-0), dhe në këtë mënyrë e ndali serinë e 21 fitoreve. Trajneri Pepe Guardiola u shpreh se skuadra e tij luajti shumë mirë, pavarësisht se nuk mundi të fitonte. Sipas tij, djemtë luajtëm më mirë se në ndeshjen me West Hamin javën e kaluar, të cilën e fituan 2-1. "Urime Manchester Unitedin për fitoren! Ishte ekip i fortë dhe na shënoi shpejt. Pas 10 minutave të para të vështira ne u rikthyem të ishim të rezikshëm. Në këtë betejë luajtëm më mirë se në ndeshjen e shkuar me West Hamin. Tri pikët në atë rast nuk ishin të merituar. Këtë herë luajtëm më mirë, por rezultati nuk ishte me ne", ka deklaruar Guardiola.

#### Reali i jep ultimatum Ramosit

Sergio Ramosi është çështja më e rëndësishme në Madrid. Kontrata e kapitenit përfundon në qershor dhe rinovimi ende nuk duket si një çështje, që po merr rrjedhë. Trajneri Zinedine Zidane ditë më parë apeloj për të mbyllur këtë çështje dhe vetë klubi është vënë në veprim. Nga Spanja, "Marca" zbulon se Real Madridi i ka vënë një ultimatum kapitenit. Afati i fundit kur ai duhet të vendosë për të ardhmen e tij është fundi i marsit. Përtej këtij ultimatum, Ramos dhe drejtuesit gëzojnë marrëdhënie të përzemërta dhe rinovimi është më i mundshëm se largimi.

## Laporta: Messi nuk largohet, e dashuron Barcelonën

Presidenti i ri i Barcelonës, Joan Laporta, ka shpresa se Lionel Messi do të qëndrojë në "Camp Nou", pasi sulmuesi argjentinas e dashuron Barçën. Laporta u rikthye në postin e presidentit të

klubit pas 11 vjetëve dhe synimi i tij i menjëhershëm është për ta gjetur një mënyrë për ta mbajtur Messin. Messi, i cili ishte buzë largimit nga klubi ku e kaloi gjithë karrierën verën e kaluar kur e

kërkoj zyrtarisht largimin nga Barça, ka marrëveshje me klubin vetëm deri në qershor dhe është i lirë të largohet falas në përfundim të sezonit. "Sot bëhen 20 vjet që prej kur një djalosh me emrin Leo

Messin debutoi për ekipin e të rinjve të Barcelonës (U12-13). Ta shohësh lojtarin më të mirë në botë duke ardhur për të votuar me djalin e vet është shembull i asaj që kemi thënë. Leo e dashuron

Barcelonën. Lojtari më i mirë në botë e dashuron Barcelonën", ka shtuar Laporta. "Shpresoj se kjo do t'i ndihmojë atij të qëndrojë në Barcelonë. Këtë e do ai", ka deklaruar ai.



## K O N K U R S

### Pozita - "Zyrtar për Kamera dhe GPS"

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Orari i punës: I plotë.

### Detvrat dhe përgjegjësitë

- Monitoron, kontrollon dhe mirëmban kamerat dhe GPS-at në autobusë.
- Bën regjistrimin dhe identifikimin e problemeve të cilat paraqiten në incidimet e kamerave dhe GPS-ve,
- I nxjerrë raportet, problemet të cilat paraqiten gjatë orarit të operimit dhe i ruan ato nga kamera dhe GPS.

### Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollimi i lartë: TIK, Menaxhment dhe Informatikë, Shkenca Kompjuterike ose të ngjashme nga fushat teknike,
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontroll,
- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike me kamera dhe GPS,
- Njohja e gjuhës angleze është e nevojshme,
- Përvoja e punësme përparësi,
- Gatishmëri për të punuar natën sepse është specifike mirëmbajtja e autobusëve gjatë ndërrimit të 3-të.

### Dokumentacioni i nevojshëm dhe mënyra e aplikimit:

1. Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com);
2. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>)
3. Dëshmi mbi shkollimi;
4. Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka)
5. Kopja e letërnjoftimit;
6. Dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime më të re se 6 muaj;
7. Dëshmi mbi patentë shoferin.

Konkursi është i hapur nga data **09.03.2021** dhe përfundon më datë **23.03.2021** në ora 24:00.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**  
**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 506/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

#### **Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-hks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
[Suzana.goranci@rks-gov.net](mailto:Suzana.goranci@rks-gov.net)  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

## K O N K U R S

**Zyrtar/e Ligjor/e**

**Numri i pozitave: 1 (një vend pune),**

**Nr. ref: 03/2021**

**Kohëzgjatja e Kontratës:** Kohë të pacaktuar

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMA-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Ofron shërbime dhe këshilla profesionale për organet e OMA-së sipas kërkesës të organeve të OMA-së dhe me referencë të Kryetarit të Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMA-së;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të punëdhënësit në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMA-së.

**Shkollimi i kërkuar:** Të ketë të kryer Fakultetin Juridik, niveli master i studimeve konsiderohet përparësi;

### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- 3 (tre) vite përvojë pune në profesion;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Të jetë fleksibil/e dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- I/e aftë të mbajë informatat konfidenciale në mënyrë të përshtatshme;
- Personalitet të përkushtuar, me iniciativë, aftësi dhe vullnet për të marrë përgjegjësi;
- Shumë i/e mirë në punë ekipore dhe aftësi për të mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

### Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMA-së, [www.omk-rks.org](http://www.omk-rks.org) dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) apo

- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

**Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **08.03.2021 deri më 23.03.2021, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “ELEKTROBITI” SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811388413 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ELEKTROBITI” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811388413, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “ELEKTROBITI” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811388413, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ “Icon Group” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330407701, Ilir Llapashtica.
- ▶ Gent Pllana shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 6-9 të shkollës fillore “Enver Hadri”
- ▶ Sadije Ferizi shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 8-të të shkollës fillore “Fazli Grajqevci”
- ▶ Refki Brahimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Bislim Imeri”
- ▶ Islam Bollopoja shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT “Arkitekt Sinani”
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

